



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1172/4Prot.

Tiranë, më 09.07.2026

V E N D I M

Nr. 188, Datë 09.07.2026

Bazuar në nenin 32 dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankimi administrativ me nr. 158 Regj., datë 24.06.2026, i znj. J. M., nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, Av. E. S., i pajisur me Prokurë të Posaçme nr. 1165 Rep., nr. 510 Kol., datë 29.05.2026, kundër subjektit “Fiber Group” sh.p.k., në të cilën pretendon diskriminim, në marrëdhëniet e punës, pa identifikuar apo pretenduar asnjë shkak konkret diskriminimi, nga ato të parashikuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas parashtrimeve të bëra në ankimin administrativ, subjekti ankues, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor, pretendon si më poshtë:

Ankuesja J. M., ka lidhur me subjektin “Fiber Group” sh.p.k. kontratën individuale të punës me afat të pacaktuar, datë 22.09.2025, për pozicionin “Operator Telefonik”, sipas së cilës marrëdhënia e punës do të ushtrohej në distancë, nga banesa e punëmarrëses, me orar pune në fashën e paradites dhe me kohëzgjatje 4-6 orë në ditë, 5 ditë në javë. Më datën 10.12.2025, punëdhënësi i ka vendosur ankuses masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me arsyetimin e mospërmbylljes së objektivave të punës. Më datën 26.01.2026, ankuesja ka kërkuar dhe i janë konfirmuar pushimet vjetore për periudhën 16-20 mars 2026, të cilat më datën 13.03.2026 i janë anuluar në mënyrë të papritur nga punëdhënësi, pa shpjegim me shkrim. Në vijim, ankuses i është komunikuar verbalisht ndryshimi i vendit të ushtrimit të punës, nga banesa në ambientet e shoqërisë (“Zyra A”), si dhe kalimi në një projekt tjetër pune, pa iu vënë paraprakisht në dispozicion apo shpjeguar kushtet e reja, përfshirë

pagesën gjatë periudhës së trajnimit dhe kriteret e vlerësimit. Më datat 19.02.2026 dhe 24.04.2026, ankuesja i është drejtuar me shkrim punëdhënësit, duke kërkuar sqarime zyrtare dhe rikthimin në kushtet fillestare të punës. Më datën 01.05.2026, punëdhënësi e ka njoftuar ankuesen se nuk kishte kaluar me sukses periudhën e ashtuquajtur “nesting”, ndërkohë që raporti i punësimit e kishte kaluar prej kohësh periudhën e provës prej 3 (tre) muajsh, të parashikuar në kontratë. Më datën 18.05.2026, nëpërmjet shkresës nr. 2429 Prot/2026, subjekti “Fiber Group” sh.p.k. i ka njoftuar ankueses ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me pretendimin e “braktisjes së vendit të punës”. Ankuesja vlerëson se kjo kronologji veprimesh përbën trajtim selektiv, diskriminues dhe viktimizues, në kundërshtim me nenin 9 të Kodit të Punës dhe me ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

- Pranimin e ankimit administrativ dhe fillimin e procedurës administrative hetimore ndaj subjektit “Fiber Group” sh.p.k.;
- Konstatimin e ekzistencës së trajtimit diskriminues dhe viktimizues ndaj ankueses, znj. J. M., në kuadër të marrëdhënieve të punës;
- Konstatimin e cenimit të parimit të trajtimit të barabartë dhe të respektimit të të drejtave të ankueses në marrëdhëniet e punës;
- Marrjen e masave administrative dhe nxjerrjen e rekomandimeve përkatëse ndaj subjektit punëdhënës, me qëllim ndërprerjen e çdo praktike diskriminuese apo viktimizuese dhe garantimin e respektimit të legjislacionit në fuqi;
- Administrimin si prova të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes, përfshirë, por pa u kufizuar në: kontratën e punës, komunikimet elektronike, komunikimet në platformën “Slack”, dokumentacionin mjekësor, si dhe çdo akt apo provë tjetër që vlerësohet e nevojshme gjatë procedurës hetimore;
- Kryerjen e ballafaqimit dhe marrjen e deklarimeve nga personat përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e ankueses, lidhur me rrethanat dhe mënyrën e trajtimit të saj në marrëdhëniet e punës.

Pas shqyrtimit paraprak të ankimit administrativ të depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ai kishte mangësi thelbësore të anës formale, pasi në asnjë pjesë të tij subjekti ankues nuk identifikonte apo pretendonte ndonjë shkak konkret diskriminimi, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1172/1 prot., datë 26.06.2026, të Komisionerit, i është kërkuar përfaqësuesit ligjor të subjektit ankues, Av. E. S., që të identifikojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar të diskriminimit dhe të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si më poshtë:

- Informacion në lidhje me identifikimin e shkaqeve të pretenduara të diskriminimit, në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, të shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton mbartjen e këtyre shkaqeve;
- Sqarim i qartë mbi mënyrën se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin e konsideruar diskriminues, duke përshkruar lidhjen shkakësore ndërmjet rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete të pretenduara;
- Informacion dhe dokumentacion provues në lidhje me veprimet e ndërmarra nga ana e shoqërisë për adresimin e çështjeve të ngritura në ankesë;
- Informacion nëse i ka adresuar shqetësimet për diskriminimin punëdhënësit, në momentin e konstatimit të tyre, së bashku me kopjen e ankesës dhe të përgjigjes së kthyer nga “Fiber Group” sh.p.k.;
- Informacion nëse çështja po ndiqet gjyqësisht, si dhe kopje e kërkesëpadisë përkatëse, nëse ka;
- Çdo informacion apo dokumentacion tjetër shtesë i gjykuar i nevojshëm në mbështetje të ankesës.

Nëpërmjet email-it të datës 07.07.2026, përfaqësuesi ligjor i subjektit ankues, Av. E. S., ka kthyer përgjigje ndaj kërkesës së Komisionerit, por përgjigjja e përcjellë nuk përmban informacion të ri apo dokumentacion shtesë që të plotësojë kërkesat e parashtruara me shkresën nr. 1172/1 prot., datë 26.06.2026, lidhur me identifikimin dhe provimin e shkakut të pretenduar të diskriminimit, lidhjen shkakësore me trajtimin e pretenduar diskriminues, si dhe elementët e tjerë faktikë dhe provues të nevojshëm për shqyrtimin e ankesës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, në asnjë moment nuk është identifikuar apo pretenduar ndonjë shkak diskriminimi, qoftë prej atyre të parashikuara shprehimisht në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010, qoftë edhe në kuptim të “çdo shkakut tjetër”, parashikuar në të njëjtin nen. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka pretenduar dhe as nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë për të treguar ekzistencën e ndonjë shkakut apo karakteristike individuale specifike, mbi bazën e së cilës të mund të pretendohet se ka ndodhur trajtimi diskriminues.

Identifikimi dhe dokumentimi i shkakut përbëjnë elemente thelbësore për provimin e "shkakut" të cilit subjekti ankues i atribuon pasojat e pretenduara, si rezultat i posedimit të tij. Në mungesë të identifikimit dhe dokumentimit të ndonjë shkakut konkret, nuk mund të arrihet në përfundimin se trajtimet e pretenduara nga subjekti ankues lidhen me ndonjë shkak të mbrojtur nga ligji.

Ankuesja nuk ka identifikuar dhe as nuk ka arritur të provojë me prova konkrete ndonjë shkak diskriminimi, pasi pretendimet e saj për trajtim të pabarabartë, diskriminues dhe viktimizues në marrëdhëniet e punës mbeten të lidhura vetëm me kushtet dhe rrethanat e marrëdhënies së punës (*ndryshimi i vendit të punës, masa disiplinore, anulimi i pushimeve, ndërprerja e marrëdhënies së punës*), pa u shoqëruar me pretendimin apo dokumentimin e ndonjë karakteristike personale që përbën “shkak të mbrojtur” në kuptim të nenit 1 të ligjit nr. 10221/2010 të ndryshuar. Në mungesë të identifikimit të një shkakut dhe të një baze të qartë provuese lidhur me të, pretendimi për diskriminim mbetet i pabazuar dhe nuk plotëson kriteret për tu trajtuar si rast i diskriminimit të ndaluar ligjërisht.

Për rrjedhojë, në mungesë të provave të mjaftueshme që lidhen drejtpërdrejt me ndonjë shkak të mbrojtur ligjërisht, ankesa nuk përmbush kriteret ligjore për të vijuar më tej si një çështje diskriminimi në kuptimin e nenit 3 dhe 3/1 të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, si dhe nenin 33, 4/ç, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankimit administrativ të subjektes ankuese znj. J. M., pasi bazuar në ligjin nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* të ndryshuar, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

